

Shpjegim i "Libri i teuhidit" – 3

(E drejta e Allahut ndaj njerëzve)

Mësimet të mbajtura nga dijetari i njohur Salih Ibn Abdul Aziz Muhamed Ali Shejh

(Allahu e faltë atë, prindërit e tij dhe të gjithë muslimanët!)

Përkthyes: Bilbil Talla

Redaktor: Ilir Haxhiaj

Kapitulli: Kush realizon teuhidin hyn në Xhenet pa dhënë llogari

Allahu i Lartësuar thotë:

“Vërtet, Ibrahim ka qenë prijës shembullor, i përlulur, me besim monoteist, e nuk ka qenë idhujtar.”¹

Dhe: “ata të cilët nuk e shoqërojnë Zotin e tyre me asgjë.”²

Husejn Ibn Abdurrahmani³ rrëfen: “Isha te Seid Ibn Xhubejri⁴, kur më tha: “Cili e ka parë yllin që u shkëput⁵ mbrëmë? “I thashë: “Unë”. Pastaj i thashë: “Nuk isha duke u falur, por më pickoi diçka.” Më tha: “E çfarë bëre?” – “Kërkova të më bënin rukje” - i thashë. - “Nga u nise që e bëre?” - “Nga hadithi që na e tregoi Shabiu”⁶. Ai pyeti: “Çfarë ju tregoi?” I thashë se përcillet nga Burejde ibn Husejbi se rukja lejohet vetëm për mësyshin ose për *imin*⁷. Ai tha: “Ka vepruar mirë ai që është bazuar tek ajo që ka dëgjuar”, por na ka përcjellë Ibn Abasi se Pejgamberi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: “M’u paraqitën të gjithë popujt. Pashë një profet me një grup⁸ të vogël njerëzish, një profet me një burrë, një profet me dy burra dhe një profet pa asnjë. Kur pashë një turmë të madhe, mendova se ishte populli im, por m’u tha se ishte Musai me popullin e tij. Pastaj pashë një turmë të madhe, për të cilën m’u tha se ishte populli im. Bashkë me ta ishin shtatëdhjetë mijë persona, që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari dhe pa

¹ EN-EN-NAHL: 120.

² EL-EL-EL-EL- MU’MINÛN: 59.

³ Ai është Husejn ibn Abdurrahmani Sulemi, Ebu Hudhejli Kufi. Ahmedi ka thënë për të se është i besueshëm nga dijetarët më të mëdhenj të hadithit. Ka ndërruar jetë në vitin 136 h. Shiko: “Tehdhib Kemal”: 6/521, “Siretu e’alami nubela”: 5/422.

⁴ Ai është Seid ibn Xhubejri Esemi, rob Kufi, Hafidh, i besueshëm, lexues dhe komentues. Ka lexuar tek Ali ibn Abasi dhe ka transmetuar nga ai dhe nga një grup sahabësh. Thonë se atë e vrau EL-Haxhaxhi, në vitin 95 h. Shiko: “Mearifetu kurra’ kibar”: 1/68 si edhe “Tehdhib Kemal”: 10/358.

⁵ Shiko: “Lisanu arab”: 7/220.

⁶ Ai është Amër ibn Sherahil Shabiu, Ebu Amru, dijetari i banorëve të Kufes. Ka qenë imam, ruajtës i disa dijeve. Ndërroi jetë në vitin 103 h; thonë dhe për një vit tjetër. Shiko: “Tehdhib Kemal”: 14/28, dhe “Tabekat ibn Seadi”: 6/246.

⁷ Kuptimin e ka për helmimin e akrepit. Shiko: “Nihajetu fi garibil hadith”: 1/447.

⁸ Raht - një grup nga 1- 9 veta prej burrave pa gra. Shiko: “Muhtarus – saha: faqja 254.

dënim.” Pejgamberi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) pastaj u ngrit dhe hyri në shtëpinë e tij. Njerëzit filluan të diskutonin për këtë kategori. Disa thoshin se flitej për shokët e Pejgamberit (Allahu e mëshiroftë!), të tjerë thoshin ndoshta janë ata të cilët kanë lindur në islam dhe nuk kanë bërë asnjëherë shirk, dhe kështu vazhduan duke sjellë variante të shumta. Pastaj doli Pejgamberi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe i treguan për diskutimin, ai tha: “Janë ata të cilët nuk kërkojnë rukje, nuk mjekohen me hekur të nxehtë, nuk parandiejnë fatin e keq, për shkak të shenjave ogurzeza, por vetëm Zotit të tyre i mbështeten”. Në këtë moment, u ngrit Ukashe ibn Mihsani⁹ dhe i tha: "Lute Allahun të më bëjë prej tyre!" Ai tha: "Po, ti do të jesh prej tyre". Më pas u ngrit një burrë tjetër dhe tha: "Lute Allahun të më bëjë edhe mua prej tyre. Pejgamberi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i tha: “Ta kaloi Ukashja”.

Dobitë e temës:

- Njohja e kategorive të njerëzve në lidhje me teuhidin.
- Çfarë kuptimi ka realizimi i teuhidit?
- Lavdërimi që i bën Allahu Ibrahimit (Paqja qoftë mbi të!), duke e theksuar që nuk i bënte shirk.
- Falënderimi i eulijave më të mirë, për shkak të ruajtjes së tyre nga shirku.
- Moskurimi me rukje dhe hekur të nxehtë është tregues i realizimit të plotë të teuhidit.
- Këto cilësi i përmbledh mbështetja në Allahun e Lartësuar.
- Dija e thellë e sahabëve, sepse ata e dinin që shtatëdhjetë mijë vetë do ta arrijnë këtë shpërblim vetëm përmes punës.
- Përkushtimi i sahabëve për arritjen e së mirës.
- Vlera e këtij umeti në sasi dhe në cilësi.
- Vlera e pasuesve të Musait (Paqja qoftë mbi të!).
- Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i janë paraqitur popujt e mëparshëm .
- Çdo popull do të ringjallet bashkë me Profetin e vet.
- Janë të paktë ata që i janë përgjigjur profetëve.
- Kujt nuk i është përgjigjur populli, ai profet do të vijë vetëm në Ditën e Gjykimit.
- Frytet e kësaj dije që janë: mosmashtimi me shumicën dhe mosnënçmimi i pakicës.

⁹ Ai është sahabiu i nderuar, i gëzuar, dëshmori Ukasha ibn Muhsin Ebu Muhsin Esedi, nga të parët në Bedër, që është gjithashtu prej shtatëdhjetë mijëve vetëve që do të hyjnë në Xhenet pa llogari dhe pa u dënuar. Ndërroi jetë në vitin 12h. Shiko: “Siretu E’alam Nubela”: 1/307 dhe “Tabekat ibn Seadi”: 3/92.

- Lejimi i përdorimit të rukjes kur sëmuremi nga mësyshi dhe helmi.
- Dija e thellë e të parëve në thënien: "Ka vepruar mirë ai që është bazuar tek ajo që ka dëgjuar, por unë kam dëgjuar ..." duke e bërë të qartë se hadithi i parë nuk e kundërshton hadithin e dytë.
- Të parët i shmangeshin lavdërimit për diçka që nuk e kishin.
- Thënia: "Ti je prej tyre" është shenjë e profetësisë.
- Vlera e Ukashes.
- Përdorimi i shprehjeve të tërthorta.
- Morali i lartë i Pejgamberit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

Para këtij ishte kapitulli "Vlera e njësimi të Zotit dhe çfarë gjynahesh fshin ai". Ky kapitull ka pozitë më lartë se vlera e teuhidit; Vlera e teuhidit përfshin pasuesit e tij, të cilët janë muslimanët. Nuk ka dyshim se çdo musliman ka pjesën e vet në vlerën e teuhidit dhe të fshirjes së gjynaheve. Ndërsa individë të veçantë të këtij umeti e kanë realizuar plotësisht teuhidin, prandaj ky kapitull vjen më prapa, pasi është më specifik.

Realizimi i teuhidit është boshti i këtij kapitulli. Me "realizim" kuptojmë realizimi i dëshmisë "La ilahe il'Allah Muhammedun Resulullah" (Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut), ndërsa kuptimi i realizimit të dëshmisë është pastrimi i fesë nga mbeturinat e shirkut, *bidatit* (risive) dhe gjynaheve.

Realizimi i teuhidit arrihet me përmbushjen e tre kushteve:

1. Braktisja e shirkut, me të gjitha llojet e tij (shirku i madh, i fshehtë dhe shirku i vogël).
2. Braktisja e bidatit, me të gjithë llojet e tij.
3. Braktisja e gjynaheve, me të gjithë llojet e tyre.

Duke u bazuar te kjo, themi se teuhidi arrihet në dy grada: grada e detyruar dhe grada e pëlqyeshme. Prandaj dhe ata të cilët e realizojnë teuhidin, janë në dy grada. Grada e detyruar është ajo kur njeriu braktis të tri gjërat e sipërpërmendura (shirkun dhe llojet e tij, bidatin dhe llojet e tij, gjynahun dhe llojet e tij). Grada e pëlqyeshme (mustehab) është ajo që bën diferencimin e madh të atyre që realizojnë plotësisht teuhidin. Ajo është kur njeriu nuk ka në zemër dëshirë apo synim tjetër, përveç Allahut të Lartësuar; domethënë zemra është e drejtuar e gjitha tek Allahu dhe nuk i kthehet dikujt tjetër përveç Tij. Kur ky njeri flet, flet për hir të Allahut; kur vepron, vepron vetëm për Allahun, madje edhe lëvizjet e zemrës së tij janë vetëm për Allahun.

Disa dijetarë kanë thënë se grada mustehab (e pëlqyeshme) është largimi nga ajo gjë që nuk përbën problem për tu mbrojtur nga ato gjëra që kanë problem, domethënë në lëmin e punëve të zemrës, gjuhës dhe të gjymtyrëve.

Rezultati i realizimit të teuhidit, vlera e të cilit është futja e atyre që e realizojnë atë në Xhenet pa llogari dhe pa dënim, lidhet me këto dy grada. Realizmi i tij është dhe realizim i dy dëshmimeve “La ilahe ilAllah, Muhammedun Resulullah”, pasi thënia “La ilahe il’Allah” do të thotë të realizosh teuhidin dhe të largohesh nga shirku e llojet e tij.

Thënia “Muhammedun Resulullah” ka kuptimin: të largohesh nga gjynahet dhe nga bidatet, pasi kërkesë e dëshmisë “Muhammedun Resulullah” është të ndjekësh urdhrat e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), të besosh ato që ai ka thënë dhe të largohesh nga ato gjëra që ai ka ndaluar dhe qortuar, në mënyrë që Allahu të adhurohet vetëm ashtu siç e ka caktuar Ai.

Kush kryen ndonjë gjynah apo bidat dhe pastaj nuk pendohet apo nuk e shlyen, ai nuk e ka realizuar teuhidin e detyrueshëm. Edhe nëse nuk vepron bidat, por e pranon me zemër apo thotë se nuk ka gjë, atëherë nuk e ka realizuar plotësisht e teuhidin dhe dëshminë “Muhammedun resulullah”.

Po ashtu, ata që bëjnë ndonjë lloj të shirkut, nuk e realizojnë plotësisht teuhidin. Për sa i përket gradës së veçantë, të cilën përmenda më lart, për të garojnë ata që e synojnë një gjë të tillë. Ne kërkojmë që Allahu të na mëshirojë, të na falë dhe të jetë i kënaqur me ne!

Shejhu në këtë kapitull (Kush realizon teuhidin hyn në Xhenet pa dhënë llogari) mbështetet në dy ajete dhe një hadith. Sa i përket ajetit të parë, ai është:

“Me të vërtetë, Ibrahim ka qenë prijës shembullor (me të gjitha virtytet e mira), i përlurur para Allahut, me besim monoteist dhe nuk ka qenë idhujtar”¹⁰

Ajeti është dëshmi e qartë se Ibrahim (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e realizonte plotësisht teuhidin. Kjo mbështetet te fjala e Allahut të Lartësuar, që e ka përshkruar Ibrahimin me disa cilësi, si:

1. Ai ishte "ummetun" (prijës), dhe prijësi është: imami që i ka të gjitha cilësitë e mira dhe të larta njerëzore¹¹, që nënkupton se atij nuk i mungon asgjë nga

¹⁰ EN- EN-NAHL: 120.

¹¹ Shiko: Fet’hu kadir: 3/255.

cilësitë e mira. Kjo do të thotë ta kesh realizuar plotësisht teuhidin. Në Kuran, fjala *ummet* vjen në disa kuptime,¹² ndër to është: Prijës i udhëzuar në mirësi. Sepse ai i vetëm luan rolin e një bashkësie të tërë. Dhe kush pason rrugën e tij, nuk ndihet i vetmuar dhe nuk lëkundet, pasi ai nuk është vetëm me një njeri, por me një popull të tërë¹³.

2. Realizimi i teuhidit: “I përulur, me besim monoteist.”¹⁴ Këto dy cilësi (“i përulur” dhe “me besim monoteist”) janë të lidhura me njëra-tjetrën, sepse përulja ndaj Allahut ka kuptimin: bindje e përhershme ndaj Allahut të Lartësuar.

Ndërsa "hanif", siç thonë dijetarët, është ai që rri i larguar nga rruga e idhujtarëve¹⁵. Dihet se rruga e femohuesve, së cilës Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) iu largua, përmbante shirk, bidat, gjynahe, mospënim dhe moskërkim faljeje.

“E nuk ka qenë idhujtar”¹⁶ (lem jeku). Në origjinë "jekun" lejohet në formën mohore, me kusht fshirjen e nunit (jekun), ashtu siç është në ajetin e lartpërmendur. Lejohet vendosja e nunit ashtu siç është në thënien e Allahut të Lartësuar: “Allahu nuk i fal e as nuk do t’i udhëzojë në asnjë rrugë”¹⁷ Vendosja dhe fshirja e nunit janë dy forma të lejuara në gjuhë, nëse ato vijnë në trajtën mohore.

“Prej idhujtarëve” (mushrikine) me shumësin e rregullt të "mushrik", që është emër që vjen nga rrënja e fjalës "shirk" dhe (el), siç është e njohur në gjuhën arabe, nëse futet tek kryefjala apo kundrinori, ajo është pjesëz lidhore. Përemri lidhor për dijetarët e "usulit" tregon përgjithësim, prandaj kuptimi i ajetit “nuk ka qenë idhujtar”¹⁸ është: “Nuk ka kryer kurrë asnjë lloj shirku dhe nuk është mushrik”.

Gjithashtu, thënia “nuk ka qenë idhujtar” tregon se Ibrahim rrinte larg nga ata, sepse min (prej) është pjesore që tregon distancim fizik (trupor). Ajo mund të jetë

¹² Nga kuptimet janë: “Ju jeni populli më i mirë”, pra popull (sure Al Imran: 110). Thënia “iu kujtua pas një periudhe”, pra, kohe (sure Jusuf: 45). Ajeti kutanor thotë “Ne i gjetëm etërit tanë në këtë fe”, pra fe (besim) (EZ- Zuhuf: 22). Shiko: Tefsir ibn Kethiri: 1/37.

¹³ Shiko: Tefsir Taberiu: 2/330.

¹⁴ EN- EN-NAHL: 120.

¹⁵ Shiko: Tefsir ibn Kethiri: 2/152.ç0i Oditor

¹⁶ EN- EN-NAHL: 120.

¹⁷ EN-EN-NISA” 168.

¹⁸ EN- EN-NAHL: 120.

edhe qartësuese, që domethënë se distancimi në këtë rast është largim nga shirku.

Synimi i Shejhut me përmendjen e kuptimeve të ajetit janë treguesit e realizimit të plotë të teuhidit. Allahu i Lartësuar thotë:

“Vërtet, Ibrahim ka qenë prijës shembullor (me të gjitha virtytet e mira), i përlulur para Allahut, me besim monoteist dhe nuk ka qenë idhujtar.”¹⁹

Kush i ka këto cilësi, sigurisht që e ka realizuar plotësisht teuhidin, dhe kush e realizon kështu teuhidin, futet në Xhenet pa llogari.

Imami i ftuesve, - Shejhu Muhamed Ibn Abduluehab (Allahu e mëshiroftë!) - në komentin e këtij ajeti në fund të sures Nahl, thotë²⁰: “Ibrahimi ishte prijës shembullor (me të gjitha virtytet e mira)” i tillë që, kush ndiqte rrugën e tij, nuk ndihej kurrë i vetmuar. Ai nuk u përulej as mbretërve dhe as tregtarëve të kamur. Ai ishte "hanifen" (me besim monoteist), që nuk anonte djathtas dhe majtas, ashtu siç është gjendja e disa dijetarëve që japin fetva. “Ai nuk ishte idhujtar”, jo si disa që futen në mesin e njerëzve dhe pretendojnë se janë muslimanë. Libri i tij i tefsirit është shumë i lartë dhe me komente të mençura: “Ky virtyt u dhurohet vetëm atyre që durojnë dhe vetëm atyre që kanë një fat të madh”²¹

Pas kësaj thotë: “Dhe thënia “Që nuk i shoqërojnë asgjë (në adhurim) Zotit të tyre”²² Ky ajet në suren "Muminun" është lavdërim i veçantë për besimtarët.

Aspekti argumentues i ajetit për këtë kapitull: Allahu thotë: “që nuk i shoqërojnë asgjë (në adhurim) Zotit të tyre”.

Thënia “nuk i shoqërojnë” mohon shirkun, siç e përmendëm më sipër. Nëse trajta mohore vjen në kohën e tashme, nënkupton përgjithësim dhe emri nxirret nga folja, si për shembull: Ata që nuk i bëjnë shirk Zotit të tyre, apo nuk bëjnë as shirk të madh, as shirk të vogël dhe as shirk të fshehtë. Ai i cili nuk bën shirk, është ‘njësues i Zotit’ (*muvahid*). Këtu kemi të bëjmë me një lidhje të pandashme, që është: “Kush nuk i bën shirk Allahut, ka zgjedhur ta njësojë Atë”.

Dijetarët thonë se fjala “Zotit të tyre” vjen që në fillim të ajetit: “që Zotit të tyre nuk i shoqërojnë asgjë (në adhurim)”, pasi rrjedhojë e teuhidit rububije është teuhidi

¹⁹ EN- EN-NAHL: 120.

²⁰ Në librin e tij: “Tefsir ajat min kur’ani kerim”: faqja 237.

²¹ FUSSILET: 35.

²² EL-EL-EL-EL- MU’MINÛN: 59.

uluhiye, kështu mosbërja shirk Allahut në teuhidin rububije nënkupton mosbërjen shirk në bindje dhe në adhurim. Ky është përshtkrimi i atyre e kanë realizuar plotësisht teuhidin.

Pjesë e mosrënies në shirk është edhe mosndjekja e epshit, pasi kush i bën ortak Zotit epshin, bie në bidat apo bën gjynahe. Në këtë mënyrë, mohimi i shirkut është mohim i të gjitha llojeve të tij, i bidatit me të gjitha llojet e tij dhe i gjynahut me të gjitha llojet e tij. Kjo do të thotë të jetësosh teuhidin e Allahut të Lartësuar. Kështu ajeti kuranor shpjegon titullin e kapitullit: “Kush realizon teuhidin, hyn në Xhenet pa dhënë llogari.”

Hadithi është i gjatë dhe pjesa argumentuese e tij është thënia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!):

“M’u paraqitën të gjithë popujt. Pashë një profet me një grup²³ të vogël njerëzish , një Profet me një burrë, një Profet me dy burra dh e një profet pa asnjë. Në këtë kohë pashë një turmë të madhe , mendova se ishte populli im, por m’u tha se ishte Musai me popullin e tij. Pastaj pashë një turmë të madhe, për të cilën m’u tha se ishte populli im. Bashkë me ta ishin shtatëdhjetë mijë persona, që do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari dhe pa dënim.”

Pejgamberi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) pastaj u ngrit dhe hyri në shtëpinë e tij. Njerëzit filluan të diskutonin për ta. Disa thoshin se flitej për shokët e Pejgamberit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), të tjerë thoshin ndoshta janë ata të cilët kanë lindur në Islam dhe nuk kanë bërë asnjëherë shirk, dhe kështu vazhduan duke sjellë variante të shumta. Pastaj doli Pejgamberi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe i treguan për diskutimin, ai tha:

“Janë ata të cilët nuk kërkojnë rukje, nuk mjekohen me hekur të nxehtë, nuk parandiejnë fatin e keq për shkak të shenjave ogurzeza, por vetëm Zotit të tyre i mbështeten”.

Ky hadith tregon cilësitë e atyre njerëzve që do hyjnë në Xhenet pa llogari dhe pa dënim. Mes tyre janë edhe këto cilësi shumë të veçanta për këta njerëz, që i bën të spikatur nga të tjerët. Pra, cilët janë ata që e kanë realizuar teuhidin? Përgjigjja ndodhet në thënien e Profetit: “Janë ata të cilët nuk kërkojnë rukje, nuk mjekohen me hekur të nxehtë, nuk parandiejnë fatin e keq për shkak të shenjave ogurzeza, por vetëm Zotit të tyre i mbështeten”.

²³ Raht - një grup nga 1- 9 veta prej burrave pa gra. Shiko: M uhtarus – sahad: faqja 254.

Katër cilësitë e përmendura janë:

1. “Janë ata të cilët nuk kërkojnë rukje” - Pasi kërkimi i rukjes e bën zemrën të mbështetet te kënduesi si shkak, derisa t’i largohet shqetësimi. Ky veprim merr një ngjyrim negativ, për shkak se njeriu e lidh zemrën me rukjen më shumë se me mjekësinë e të ngjashme. Arabët në kohën e injorancës – dhe shumica e njerëzve sot – lidhen pas rukjes. Kështu, zemra lidhet me kënduesin e rukjes dhe një gjë e tillë zhvlerëson mbështetjen e plotë tek Allahu i Lartësuar.

Sa i përket disa transmetimeve ku thuhet “Të cilët nuk bëjnë rukje”, ato janë të pasakta, sepse kënduesi nuk mund të qortohet për veprimin e tij bamirës. I saktë është ky transmetim, që thotë: “Janë ata të cilët nuk kërkojnë rukje”.

2. “Nuk mjekohen me hekur të nxehtë”. Në origjinë, mjekimi me hekur të nxehtë është i papëlqyeshëm, se shkakton dhimbjen e djegies. Në Sheriat është e lejueshme, por e papëlqyeshme. Arabët besojnë se mjekimi me hekur të nxehtë shëron përfundimisht, ndaj i lidhin zemrat me këtë lloj mjekimi, duke besuar se ai ka ndikim përgjithmonë. Dihet që mjekimi me hekur të nxehtë ndikon me leje të Allahut, nëse bëhen shkaqet dhe shmangen pengesat.

Megjithatë, papëlqyeshmëria e përdorimit të hekurit lidhet veçanërisht me faktin se njerëzit mbajnë shpresa të mëdha te ky lloj kurimi.

3. “Nuk parandiejnë fatin e keq për shkak të shenjave ogurzeza”. - Parandjenja e fatit me shenja ogurzeza zë vend në zemër dhe e shtyn dikë të bëjë apo të mos bëjë diçka. Kjo u ndodh zemrave që nuk i mbështeten Allahut aq sa duhet.
4. “Por vetëm Zotit të tyre i mbështeten”. - Kjo përmbledh të gjitha cilësitë e lartpërmendura. Kjo nuk do të thotë se, ata të cilët e realizojnë teuhidin plotësisht, nuk i marrin shkaqet, siç mund ta kuptojë dikush, as se jetësimi i plotë i teuhidit kërkon të mos ndiqen shkaqet për shërim. Është gabim të mendohet kështu, sepse edhe Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i është kënduar rukje²⁴, është mjekuar dhe ka urdhëruar që njerëzit të mjekohen²⁵,

²⁴ I lexoi rukje Xhebraili, ashtu siç thuhet në hadithin e Ebi Seidit, të cilin e ka transmetuar Muslimi: 2186.

²⁵ Transmeton Ahmedit: 4/278 me nr. hadithi: 18455, Tirmidhiu: 2038 nga hadithi Usama ibn Sherik dhe teksti i Ahmedit: “Mjekohuni, o robër të Allahut. Allahu ka lëshuar për çdo sëmundje edhe ilaçin e saj, përveç vdekjes dhe plakjes”.

madje ka urdhëruar disa sahabë të kurohen me hekur²⁶ të nxehtë. Hadithi nuk tregon se këta persona nuk kryejnë asgjë nga shkaqet e dobisë apo nuk bëjnë shkaqet e kurimit, por këto tri cilësi janë përmendur posaçërisht për faktin se ndikojnë më shumë që zemra të lidhjet me kënduesin e rukjes, mjekimin me hekur dhe shenjat ogurzeza. Të gjitha këto cenojnë gradën e mbështetjes së plotë tek Allahu i Madhërishëm.

Sa i përket kurimit, ai është i ligjëruar. Ai herë është *vaxhib*, herë *mustehab* dhe në disa raste është "mubah" (i lejuar). Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: "O njerëzit e Allahut, kurohuni, por mos u kuroni me haram (të ndaluara)."²⁷ Qëllimi është se kurimi nuk e cenon realizimin e plotë të teuhidit, por cilësia e veçantë e atyre që e përmbushin atë është moskërkimi i rukjes, mosmjekimi me hekur dhe heqja dorë nga shenjat ogurzeza. Përveç këtyre, gjërat e tjera të lejuara nuk ndikojnë në veçantitë e realizuesit të plotë të teuhidit.

Mendimi im është se thënia: "Nuk kërkojnë rukje, nuk mjekohen me hekur të nxehtë, nuk parandiejnë fatin e keq për shkak të shenjave ogurzeza", është veçanërisht për këto tri cilësi.

"Në këtë moment, u ngrit Ukashe Ibn Mihsani²⁸ dhe i tha: "Lute Allahun të më bëjë prej tyre!" Ai tha: "Po, ti do të jesh prej tyre". Më pas, u ngrit një burrë tjetër dhe tha: "Lute Allahun të më bëjë edhe mua prej tyre!" Pejgamberi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i tha: "Ta kaloi Ukashja"

Ky hadith tregon se ata që e realizojnë të plotë teuhidin, janë pak. Madje thuhet se numri i tyre është vetëm shtatëdhjetë mijë. Në disa transmetime, tek imam Ahmed²⁹ dhe të tjerë³⁰, thuhet se Allahu i Madhëruar i ka dhuruar të Dërguarit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) për çdo një mijë persona shtatëdhjetë mijë dhe numri i atyre që do hyjnë në Xhenet pa llogari dhe pa dënim nga anëtarët e këtij umeti arrin afërsisht në pesë miliardë. Nëse ky hadith është i

²⁶ Por ka qenë mjekues për të tjerët. Transmetohet nga Xhabiri se ka thënë: "Babai im u qëllua me shigjetë në damarin e gjakut në krah, në luftën e Ahzabit, dhe e mjekoi i Dërguari i Allahut me hekur të nxehtë".

²⁷ Ebu Dauti: 3873, Tabaraniu në Kebir: 24/254 me nr. 649, të ngjashëm si hadithi i Ummu Dardai.

²⁸ Ai është sahabi i nderuar, dhe i gëzuar, dëshmori Ukasha ibn Muhsin Ebu Muhsin Esed, nga të parët në Bedër. Ai është prej shtatëdhjetë mijëve vetëve që do të hyjnë në Xhenet pa llogari dhe pa dënim. Ndërroi jetë në vitin 12 h. Shiko: "Siretu e'alami nubela": 1/307 dhe "Tabekat ibn Seadi": 3/92.

²⁹ Në Musned: 5 faqja 250, me nr. 22156.

³⁰ Si Tirmidhiu: 2437, Ibn Maxheh:4286, nga hadithi Ebi Enameh Bahili.

saktë, numri që përmendet, siç thonë disa nga dijetarët, nuk ka domethënie.³¹ Ose kishte kuptim para se Profetit të kërkonte shtimin e atyre që e realizuan plotësisht teuhidin.

Lind pyetja: Çfarë kuptimi ka të shtohet numri i tyre? Përgjigjja është se Allahu i Madhëruar do derdhë mirësinë e Tij mbi disa njerëz të këtij umeti, përveç shtatëdhjetë mijave, të cilët do vijnë më pas. Ai do t'u mundësojë atyre ta përmbushin teuhidin, pasi Ai i jep sukses kujt të dëshirojë, Ai është udhëzuesi dhe Ai është shpërblyesi. Sa Bamirës i madh, sa Bujar dhe sa i Mëshirshëm është Allahu!

³¹ Prej tyre është Ibn EL-HAXHeri në Fet'hul Bari: 11/410, Ibn Kajim në Hedji Ervah faqja 90 dhe Albani në *Sahih Sunenu Tirmidhi*.